



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 17, datë 23.04.2020

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESAVE ME EMËRTIMIN “QËNDRA SHËNDETËSORE”, QË MBAJNË NR. 15 DHE 17 TË LISTËS, QË ME VKM NR. 295, DATË 2.5.2012, KANË KALUAR NË PRONËSI TË KOMUNËS ISHËM (SOT BASHKIA DURRËS), PËR SHKAK SE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE SE NUK MUND TË RIPAROHEN, SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, TË PRONËS ME NR.15, ME VENDODHJE NË FSHATIN LIKMETAJ DHE NR.17, ME VENDODHJE NË FSHATIN DRAÇ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, ME EMËRTIMIN “QËNDRA SHËNDETËSORE”, QË ME VKM NR. 295, DATË 2.5.2012, KANË KALUAR NË PRONËSI TË KOMUNËS ISHËM (SOT BASHKIA DURRËS)

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 295, datë 2.5.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.182/5 prot., datë 19.02.2020, ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me lëndë “Dërgim i akt-ekspertizave të thelluara”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z.Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

#### V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesave me emërtimin “Qendra Shëndetësore”, që mbajnë nr.15 dhe 17 të listës, që me VKM nr.295, datë 2.5.2012, kanë kaluar në pronësi të komunës Ishëm (sot Bashkia Durrës), për shkak se janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe se nuk mund të riparohen, sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista e pronave të Njesisë Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, të pronës me nr.15, me vendodhje në fshatin Likmetaj dhe të pronës me nr.17, me vendodhje në fshatin Draç, Njësia Administrative Ishëm, me emërtimin “Qendra Shëndetësore”, që me VKM nr. 295, datë 2.5.2012, kanë kaluar në pronësi të komunës Ishëm (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Ishëm, në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me nr.15, me vendodhje në fshatin Likmetaj dhe nr.17, me vendodhje në fshatin Draç, Njësia Administrative Ishëm, me emërtimin “Qendra Shëndetësore”, që me VKM nr. 295, datë 2.5.2012, kanë kaluar në pronësi të komunës Ishëm (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli) e liruar nga prishja e dy ndërtesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij projektvendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoren për rindërtimin e dy ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e dy objekteve të përcaktuara në pikën 1 të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administrojnë fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave,

prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e Qëndrave Shëndetësore të përcaktuara në pikën 1 të këtij projektvendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesave Qendra Shëndetësore.

7. Për zbatimin e këtij vendimi Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Publike, Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtorja e Përgjithshme Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

### KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 23.04.2020**